




	Raport për tremujorin e tretë 2012	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 1 nga 44</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>

KOSTT

OPERATOR SISTEMI TRANSMISIONI QJE TREGU KOSTT d.d.
TRANSMISSION SYSTEM AND MARKET OPERATOR KOSTT J.S.C
OPERATOR SISTEMA PRENOSA I TRZIŠTA KOSTT d.d.
Nr. 806 Dt. 26/11/2012
PRISHTINË-A

Raport për tremujorin e tretë 2012

(01.07.2012-30.09.2012)

	Përgatiti	Kontrolloi	Aprovoi
Emri Mbiemri	Nebih Haziri	Fadil Ismajli	Kryesuesi i BD Ramadan Paçarada
Nënshkrimi			
Data	20/11/2012	21/11/2012	21.11.2012

	Raport për tremujorin e tretë 2012	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 2 nga 44</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>

Raport Tremujor për Bordin e Drejtorëve në KOSTT
Përiudha Korrik – Shtator 2012

1	Titulli i Dokumentit	Raport Tremujor 2012
2	Dërguesi i dokumentit	Fadil Ismajli, Kryeshf Ekzekutiv
3	Përmbajtja e Raportit	<p> Kapitulli 1: Pasqyra e strukturës organizative dhe ndryshimet që janë bërë gjatë tremujorit të tretë të vitit 2012 </p> <p> Kapitulli 2: Shqyrtim i performancës afariste dhe financiare </p> <p> 2.1. Raport i realizimit të Indikatorëve Kyç të Performancës – operimi i sistemit dhe operimi i transmisionit 2.2. Raport i operimit të tregut 2.3. Statusi i investimeve (projekteve) kapitale në KOSTT 2.4. Çështjet rregullative 2.5. Shqyrtimi i performancës financiare </p> <p> 2.5.1. Pasqyrat financiare (Bilanci i Gjendjes dhe Pasqyra e Fitimit/Humbjes, Realizimi i projekteve kapitale nga BK gjatë tremujorit të tretë të vitit 2012) 2.5.2. Analiza e IKP-ve financiare </p> <p> Kapitulli 3 : Përmbledhja dhe përshkrimi i procedurave gjyqësore </p> <p> Kapitulli 4: Kontratat/Transakcionet e konsiderueshme gjatë tremujorit të tretë të vitit 2012 nga burimet e KOSTT </p> <p> Shtojcë 1: Raporti për funksionimin e qeverisjes korporative </p>
4	Data e Raportimit	

	Raport për tremujorin e tretë 2012	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 3 nga 44</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>

Hyrje

Raporti tremujori Korrik – Shtator 2012 përmban të gjitha elemente konform nëniti 31.1 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, ku brenda 30 ditëve pas përfundimit të çdo tremujori kalendarik, zyrtarët e NP-së do të përgatisin një raport për tremujorin e sapo përfunduar (“tremujori përkatës”) i cili i dorëzohet Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it për miratim.

Pas miratimit të këtij Raporti nga Bordi i Drejtorëve të KOSTT-it, ky Raport do të dërgohet te Njësia për Politikën dhe Monitorimin të NP-ve.

Raporti paraqet rezultatet kryesore të aktiviteteve të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve gjatë tremujorit të tretë të këtij viti si dhe të aktiviteteve krahasuar me planin vjetor dhe shkallën e realizimit.

Në kapitujt e këtij Raporti, paraqiten të dhënat kryesore për strukturën organizative dhe ndryshimet e bëra, shqyrtimi i performancës afariste dhe financiare, e shprehur edhe me Indikatorët Kyç të Performancës (IKP) teknike dhe financiare, të dhënat rreth operimit të tregut, projektet aktive në KOSTT të paraqitura sipas vlerës, afateve dhe statusit të tyre, procedurat gjyqësore ose të arbitrazhit të pambaruar, transaksionet e konsiderueshme të tremujorit të tretë, për të përfunduar me Shtojcën, e cila paraqet funksionimin e qeverisjes korporative të KOSTT-it.

Përbërja e Raportit është identike me përbërjen e definuar në nënin 31.1 të Ligjit Nr. 03/L-087.

	Raport për tremujorin e tretë 2012	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 4 nga 44</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik</i>

1. Pasqyra e strukturës organizative dhe ndryshimet gjatë tremujorit të tretë 2012

1.1. Organizimi

Struktura organizative e KOSTT-it është e përbërë nga Bordi i Drejtorëve dhe Menaxhmenti. KOSTT është përcaktuar të ketë një afarizëm të pavarur dhe si i tillë reflekton një fushëveprim bilateral të afarizmit.

Afarizmi i KOSTT zhvillohet nga 8 (tetë) Departamente, 3 (tri) Zyre të përbëra në strukturën e Drejtorisë Qendrore. Në strukturën e KOSTT janë të përfshira edhe pozitat e Kryeshefit Ekzekutiv(KSHE), 2 (dy) Zëvendës të KSHE, njeri me përgjegjësi për operim ndërsa tjetri për zhvillim, Sekretarit të Kompanisë, Zyrtarit Kryesor Financiar dhe të Trezorit, si dhe Zyrtarit për Auditimin e Brendshëm.

Organizimi i KOSTT është bazuar në afarizmin themelor tekniko-operativ, ku mbulohet me Departamentet:


- Operatori i Sistemit
- Operatori i Transmisionit
- Operatori i Tregut

Afarizmi tjetër ka karakter projektues, komercial, rregullativ, ligjor, marrëdhënieve me punëtorë, administrativ, zhvillimit të personelit, teknologjisë së informacionit dhe zhvillohet përmes Departamenteve mbështetëse:

- Inxhinieringu dhe Menaxhimi i Projekteve
- Çështjet Ligjore dhe Rregullative
- Financat
- Burimet Njerëzore dhe
- Prokurimit

Në Drejtorinë Qendrore të KOSTT-it janë edhe tri njësi, të emëruara si Zyre, të cilat kanë karakter mbështetës në aspektin e obligimeve financiare, ligjore dhe organizative, që janë:

- Zyra për Zhvillim dhe Planifikim Afatgjatë
- Zyra për Komunikim dhe Relacionë me Publikun dhe
- Zyra për Siguri Industriale dhe Mjedis

	Raport për tremujorin e tretë 2012	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>fage 5 nga 44</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>	

1.2. Numri i Punëtorëve

Me datën 1 Korrik 2012 numri i përgjithshëm i të punësuarve në KOSTT ka qenë 367, ndërsa me datën 30 shtator 2012 numri i të punësuarve është 369.

Arsyeja e rritjes të numrit të punëtorëve është se gjatë kësaj periudhe tremujore Korrik-Shtator 2012, kanë filluar punën dy punëtorë të rinjë në këto pozita:

Një (1) Inxhinier për SCADA

Një (1) Praktikant - jurist

Në vazhdim është dhënë Organogrami – Makro Struktura organizative aktuale e KOSTT-it.



Raport për tremujorin e tretë 2012


DT-FI-008


ver. 1.1

faqe 6 nga 44

Departamenti Financiar

Sektori i Buxhetit dhe Planifikimit Strategjik:



	Raport për tremujorin e tretë 2012	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 7 nga 44</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>	

Shqyrtimi i performancës afariste dhe financiare


2.1. Raport për operimin e sistemit dhe transmisionit për Indikatorët Teknik të Performancës

2.1.1. Balanca e planifikuar dhe e realizuar për Korrik – Shtator 2012


Muajt	Korrik-Shtator			
	MWh	E planifikuar	E realizuar	Real/Plan%
(1) TC Kosova A		360 720	477 391	132.34
(2) TC Kosova B		536 280	565 208	105.39
(3) Energjia për shpenzime vetanake (TC A+TC B)		31 640	0	0.00
(4) HC Ujmani		14 000	13 666	97.61
(5) HC Lumbardhi		3 769	2 498	66.28
(6)= 1+2+3+4 Prodhimi në prag të transmisionit		942 640	1 056 265	112.05
(7) Devijimi		0	5 031	0.00
(8) Eksporti		20 547	90 111	438.56
(9) Importi		254 390	154 727	60.82
(10) = 6-7-8+9 Energjia në disponim		1 176 483	1 115 850	94.85
(11) Distribucioni		897 506	901 316	100.42
(12) Ferronikeli		165 600	90 568	54.69
(13) Trepça		5 098	5 054	99.14
(14) Sharri		18 900	15 649	82.80
(15) Mihjet dhe konsum.jasht KEK		32 100	31 514	98.17
(16) Shpenzimet vetanake të TC nga transmisioni(LP290,B1,B2,T12,T34,T35,T45)		31 640	48 174	152.26
(17) = 11+12+13+14+15+16 Kërkesa neto		1 150 844	1 092 275	94.91
(18) Humbjet në transmission		25 639	23 575	91.95
(19) =17+18 Kërkesa gjithsej		1 176 483	1 115 850	94.85

Të dhënat e planifikuara janë marrë nga dokumenti Balanca Vjetore e Energjisë Elektrike 2012, ndërsa të dhënat e realizuara nga pikat matëse dhe të transferuara në kufi të Kosovës.


Shpjegim: (3) Energjia për shpenzime vetanake nga (TC A dhe TC B) e cila hyn në rrjetin e transmisionit është e barabartë me energjinë që termocentralet e marrin nga rrjeti i transmisionit për shpenzime vetanake (17). Rreshti (3) në tabelë në vlerat e realizuara është e përfshirë në pikën (6)- Prodhimi në prag të transmisionit.


	Raport për tremujorin e tretë 2012		DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 8 nga 44</i>	
<i>Departamenti Financiar</i>			
<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>			

Të dhënat në tabelë janë ilustruar edhe në diagramin vijues:



Diagrami i balancës së realizuar elektroenergjetike Korrik -Shtator 2012(GWh)



	Raport për tremujorin e tretë 2012		DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i> <i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>		<i>faqe 10 nga 44</i>
<i>Departamenti Financiar</i>			

2.1.2. Indikatorët Kyç të Performancës - operimi i sistemit

Nr	Indikator	Korrik-Shtator		Korrik-Shtator 2012	2012/2011 (%)	Caku	Komenti
		2011	2012				
T1	* Energjia që hyn në transmision (GWh)	1991.69	1801.40	1801.40	90.45	Nuk mund të vendoset sepse nuk mund të parashihet transiti, e me këte as hyrjet totale në transmision	Caku nuk vendoset për këtë IKP
T2	Piku koincident (MW)	740	739	739	99.86	Caku: 1100MW (Sipas: Balanca Vjetore e Energjisë Elektrike 2012).	Caku nuk vendoset për këtë IKP, por shihet që 0,14 % është pikë më i lartë në periudhën Korrik-Shtator 2011 se sa Korrik-Shtator 2012.
T3	Gjatësia totale e linjave (km)	400 kV	181.815	188.49	103.67	=>1	Caku mund të vendoset për çdo vit me ndërtimin e linjave të reja ose riparimin/rindërtimin e linjave të cilat aktualisht nuk janë në operim. Ky cak bazohet në Planin Zhvillimor të Transmisionit. Gjatësitë e linjave dhe kapaciteti në nivelin 400kV dhe 110kV për periudhën Korrik-Shtator 2012, është rritur për shkak të lëshimit në operim të NS 400/110kV Ferizaji 2 dhe linjave ndërlidhëse 400kV dhe 110 kV.
		220 kV	231.882	231.882	100.00		
		110 kV	727.6	764.94	105.13		
T4	MVA-km	400 kV	239450	248249	103.67	=>1	Caku është si në T3. Gjatësitë e linjave dhe kapaciteti në nivelin 400kV dhe 110kV për periudhën Korrik-Shtator 2012,
		220 kV	77506	77506	100.00		
		110 kV	80573	83209	103.27		



**Raport për tremujorin e tretë
2012**

DT-FI-008

ver. 1.1

faqe 11 nga 44

Departamenti Financiar

Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:

								është rritur për shkak të lëshimit në operim të NS 400/110kV Ferizaj 2 dhe linjave ndërlihdhëse 400kV dhe 110 kV.
T5	Kapaciteti i transformatorëve	400-220;400-110 kV	1500	1800	120.00	=>1		Ky cak mund të vendoset për çdo vit për instalimin e transformatorëve të ri.
		220-110 kV	1200	1200	100,00			
T6	Kapaciteti i Disponueshëm Mesatar Import/Eksport(AATC)							I paaplikueshëm për shkak se KOSTT nuk është anëtare e ENTSO-E
T7	Kapaciteti i Disponueshëm Maks. Import/Eksport MATC							I paaplikueshëm për shkak se KOSTT nuk është anëtare e ENTSO-E
T8	Pagesa për kongestion							KOSTT do të fillojë kur ATC të alokohet nga OT/kontrollohet nga OS për TTC teknike.
T9	Koha mesatare e ndërprerjes (AIT minuta/vit)		16.25	82.58	508.18			AIT (Koha mesatare e rënies) 16,25 minuta gjatë tre muajve Korrik-Shtator 2011, ndërsa 82,58 minuta për periudhën e njëjtte 2012. Koha mesatare e ndërprerjes, është më e madhe gjatë periudhës Korrik-Shtator 2012 për shkak se energjia e pafurnizuar ka qenë më e madhe, e kjo për shkak të punimeve të zhvilluara në kuadër të projektit për rehabilitimin e stabilimenteve të tensionit të lartë në NS 220/110
								Caku vendoset sipas raportit: (AIT për periudhën aktuale)/(AIT për periudhën e kaluar) < 1



DT-FI-008

**Raport për tremujorin e tretë
2012**


faqe 12 nga 44

ver. 1.1

Departamenti Financiar

Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:

T10	Numri i ankesave për tension	0	0				Nr i përgjigjeve / Nr ankesave =1	Caku për ankesa për tension duhet të ndërlidhet me numrin e ankesave në vitin (et) paraprak në periudhën e njëjtë dhe mundësia e zgjidhjes së ankesës duhet të jetë në kohë sa më të shkurtrët.
T11	Ankesat e zgjidhura për tension	Më pak se një javë	0	0			Nr i përgjigjeve / Nr ankesave =1	Caku për zgjidhjen e ankesave për tension duhet që në kohë sa më i shkurtrët që të jetë e mundur(< 1 javë) të shqyrtohet ankesa.
		Më pak se një muaj					Nr i përgjigjeve / Nr ankesave =1	
		Më shumë se një muaj					Nr i përgjigjeve / Nr ankesave =1	Caku për ankesa të matjeve duhet të ndërlidhet me numrin e ankesave për vitin(et) paraprak(e).
T12	Numri i ankesave për matje	0	0					
T13	Ankesat e zgjidhura për matje	Më pak se një javë	0	0			Nr i përgjigjeve / Nr ankesave =1	Caku për zgjidhjen e ankesave për matje duhet që në kohë sa më i shkurtrët që të jetë e mundur(< 1 javë) të shqyrtohet ankesa.
		Më pak se një muaj					Nr i përgjigjeve / Nr ankesave =1	
		Më shumë se një muaj					Nr i përgjigjeve / Nr ankesave =1	
T14	Vlera mesatare absolute e devijimeve orare Programi (MWh/orë)	Import	23.20	24.31	104.77		20MWh/h tërheqje jashta programit të deklaruar	Stafi i Qendrës së Kontrollit ka për qëllim që devijimet mesatare absolute në orë të programeve të importeve/eksporteve të jenë sa më të vogla.
		Eksport	20.03	25.91	129.32		20MWh/h shtyerje jashta programit të deklaruar	

	Raport për tremujorin e tretë 2012		DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i> <i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>		<i>faqe 13 nga 44</i>
<i>Departamenti Financiar</i>			


T15	Humbjet në transmission (GWh)	22.21	23.57	106.14	Humbjet e energjisë elektrike në transmission kanë qenë për 6,14 % më të mëdha në periudhën Korrik-Shtator 2012 se sa në periudhën e njëjtë 2011. Humbjet në transmission në periudhën Korrik-Shtator 2012 janë më të larta për shkak të kalimit të transformatorëve 110kV nga KEK në KOSTT, por megjithatë humbjet në transmission janë ende brenda vlerave të lejuara nga ZRRF.
------------	----------------------------------	--------------	--------------	---------------	---

AIT=(8760*60*ENS)/TE

ENS-Energy not supplied - EPF-Energjia e pafurnizuar

TE-Transmitted energy - ET- Energjia e transmetuar (Energjia që hyn në transmission) është energjia e cila hyn në transmission nga prodhimi i gjeneratorëve (Prodhimi në prag të transmissionit) dhe importeve si rrjedha fizike nga linjat interkonektive (import flow).

AIT- Average interruption time - KMR - Koha mesatare e rënieve

 Departamenti Financiar	Raport për tremujorin e tretë 2012	DT-FI-008
	ver. 1.1 Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:	faqe 14 nga 44

2.1.3. Indikatorët Kyç të Performancës - operimi i transmisionit

Nr	Indikatorit	Niveli i tensionit	2011		2012		Krahاسimi 2012/ 2011 (%)	Caku	Komenti
			Korrik-Shtator	Korrik-Shtator	Korrik-Shtator	Korrik-Shtator			
T1	Numri i prishjeve në linja në 100km gjatësi	400	0.00	0.00	0.00	0			
		220	0.86	1.3	1.51				
		110	0.41	0.42	1.02		>1		
T2	Koha mesatare e riparimit të prishjes në linjë(orë)	400	0.00	0.00	0				
		220	2.44	3.11	1.27				
		110	2.42	4.04	1.66		>1		
T3	Koha mesatare e shkycjes për shkak të mirëmbajtjes së linjës (minuta)	400	0.00	0.00	0				
		220	0.00	0.00	0				
		110	0.00	0.00	0		≤1		
T4	Numri i prishjeve në transformator në 100 transformator(njësi)	400/220(110)	0.00	0.00	0				Nuk mund të mirret parasysh sepse nuk ka koeficient krahasues, për arsye se këto asete këtë vit kanë kaluar në pronësi të KOSTT-it.
		220/110	0.00	0.00	0				
		110/35/10	0.00	7.81	∞		>1		
T5	Koha mesatare e riparimit të prishjes në transformator(orë)	400/220(110)	0.00	0.00	0				Nuk mund të mirret parasysh sepse nuk ka koeficient krahasues, për arsye se këto asete këtë vit kanë kaluar në pronësi të KOSTT-it.
		220/110	0.00	0.00	0				
		110/35/10	0.00	0.81	∞		>1		



Departamenti Financiar

Raport për tremujorin e tretë
2012

ver. 1.1

Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:

DT-FI-008

faqe 15 nga 44

T6	Koha mesatare e shkyqjes për shkak të mirëmbajtjes së transformatorit (minuta)	400/220(110)	0.00	0.00	0	≤ 1
		220/110	0.00	0.00	0	
		110/35/10	0.00	0.00	0	
T7	Numri i prishjeve në stabilimente të TL në 100 fusha	400	0.00	0.00	0	≤ 1
		220	0.00	0.00	0	
		110	0.00	0.00	0	
T8	Koha mesatare e riparimit të prishjes në stabiliment (orë)	400	0.00	0.00	0	≤ 1
		220	0.00	0.00	0	
		110	0.00	0.00	0	
T9	Koha mesatare e shkyqjes për shkak të mirëmbajtjes së stabilimentit (fushës)(minuta)	400	0.00	0.00	0	≤ 1
		220	0.00	0.00	0	
		110	0.00	0.00	0	
T10	Numri i prishjeve në mbrojtje rele/kontroll në 100 fusha	400	0.00	0.00	0	≤ 1
		220	0.00	0.00	0	
		110	0.00	0.00	0	
T11	Koha mesatare e riparimit të prishjes në mbrojtje rele/kontroll (orë)	400	2.77	0.00	0	≤ 1
		220		0.00	0	
		110	2.10	0.00	0	
T12	Koha mesatare shkyqjes për shkak të mirëmbajtjes së mbrojtjes rele/kontrollit (minuta)	400	0.00	0.00	0	≤ 1

	Raport për tremujorin e tretë 2012	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 16 nga 44</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>

2.2. Raport mbi operimin e tregut

2.2.1. Madhësia e Tregut


Tregu i energjisë elektrike në Kosovë është treg bilateral dhe i rregulluar ku mungon konkurrenca në tregun me shumicë dhe atë me pakicë. Ekziston vetëm një furnizues që furnizon konsumatorët e rregulluar dhe ata të pa rregulluar.

Për shkak të mungesës së konkurrencës dhe furnizuesve të tjerë të pavarur dhe në bazë të ligjeve të reja lejohet që konsumatori i kualifikuar të furnizohet nga Furnizuesi Publik me çmim të rregulluar i cili ndryshon nga niveli i tensionit ku ata janë të kyçur. Është arritur marrëveshje midis KEK, Feronikelit dhe ZRRrE që Feronikeli të furnizohet nga KEK me çmim të rregulluar në nivelin 220kV. Prandaj madhësia e tregut që i referohet segmentit të rregulluar në nivelin 220kV do të paraqitet si raport i energjisë së konsumuar në nivelin 220kV në raport me konsumin e përgjithshëm në Kosovë e shprehur në diagramet më poshtë.

Në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2011 në këtë vit kemi një rritje të humbjeve për 6.14% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Kjo rritje është si pasojë e ndërrimit të kufirit ku humbjet tani rriten për vlerën e humbjeve në Transformatorët 110/35kV dhe 110/10 kV.


Tranziti i energjisë elektrike në këtë tre mujorë në Rrjetin e KOSTT ka qenë 578.120MWh gjegjësisht 32% të rrjedhave fizike të energjisë nëpër rrjetin transmetues. Edhe më tuje KOSTT nuk kompensohet për këtë shërbim nga mekanizmi i ITC por kompensohet EMS (TSO e Serbisë).

Sipas vlerësimeve të KOSTT, energjia elektrike e reduktuar në këtë tre-mujor është mesatarisht rreth 1.42% e konsumit vendor, nga 2.85% sa ishte në periudhën e njëjtë në 2011. Reduktimet ekzekutohen me instrukcionet e KEK-ut.


	Raport për tremujorin e tretë 2012	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 17 nga 44</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>

Tregu i rregulluar dhe i pa-rregulluar


Energjia që ka hyrë në rrjetin transmetues




Energjia që ka dalë nga rrjeti transmetues dhe humbjet në transmision



Pjesëmarrja e konsumit tarifor dhe jo tarifor



	Raport për tremujorin e tretë 2012		DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>		<i>faqe 18 nga 44</i>
Departamenti Financiar		Sektori i Buxhetit dhe Planifikimit Strategjik:	

2.2. Statusi i investimeve (projekteve) kapitale në KOSTT

Nr	Emri i Projektit	Buxheti	Fincuar nga	Vlera e Kontrates	Data e fillimit	Data e kompletimit	Kontraktues	shpenzuar Q3	Realizimi: (i.) Progresi, (ii.) Rreziku dhe pengesat	Rekomandimet
1	Shërbime Konsulentësh për Paket Projektin NS 400/110 kV – Ferizaj 2 bashkë me Linjat Ndërlidhëse 400 dhe 110 kV	700,000.00 €	ECLO	668,500.00 €	17.12.2009	17.10.2011	INGEDIA (Ro)	0.00 €	(i.) Gjatë këtyre muajve konsulenca nuk ka pasë obligime në terren sepse projekti ka përfunduar dhe është në afatin garantues, KOSTT ka përgatitë fakturen e fundit së bashku me konsulentin për LOT 2, ndërsa sa i përket LOT1, nuk ka pasë ndonjë aktivitet.	
2	Paket Projekti Ferizaj-2 LOT-1: NS 400/110 kV Ferizaj 2	15,800,000.00 €	BK	13,656,000.00 €	24.12.2009	23.10.2012	SIEMENS (At)	0.00 €	(i.) Projekti NS 400/110 kV Ferizaj 2 është në periudhë garantuese njëvjeçare.	Kontraktuesi duhet të vazhdojë me aktivitetet për eliminimin e vërjetjeve të paraqitura nga Komisioni për Pranim Teknik Intern



Raport për tremujorin e tretë 2012

DT-FI-008

ver. 1.1

Jaqe 19 nga 44

Departamenti Financiar

Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:

3	Paket Projekti Ferizaj-2 LOT-2-LP ndërlidhëse 400 dhe 110 kV	7,500,000.00 €	ECL0	6,105,000.00 €	31.12.2009	30.10.2011	UMEL (B&H)	0.00 €	(i.) Projekti është në afatit garantues, nuk ka pasur ndonjë aktivitet	Kontraktuesi duhet të vazhdojë me aktivitetet për eliminimin e vërrejtjeve të paraqitura nga Komisioni për Pranim Teknik Intern	
4	Paket Projekti SCADA/EMS dhe Telekomit LOT-1:SCADA/EMS	8,500,000.00 €	BK	7,875,370.00 €	31.12.2008	30.06.2011	Alstom/Komtel (F/RKS)	0.00 €	(i.) Gjatë kësaj kohe është bërë SAT-i në NS Prizren 2 për disa fusha, rritësimi i interlockave, inspektimi i disponueshmërisë së RTU-ve. Gjithashtu është bërë vëzhgimi i realizimit të bllokadave në RTU dhe punimeve në NS Prizreni 2.		
5	Paket Projekti SCADA/EMS dhe Telekomit LOT-2: Telekomit	9,500,000.00 €	BK	9,214,760.00 €	31.12.2008	30.06.2011	Engroinvest/Alstom (B&H/F)	38,940.00 €	(i.) Në këtë periudhë kontraktuesit Alstom dhe Engroinvest kanë punuar në evitimin e vërrejtjeve të mbetura të komisionit intern teknik. Në ndërkohë janë montuar pajisjet telekomunikuese në NS Gjilani 5 dhe atë: Një orman me pajisje SDH/PDH dhe një rack OMDF. Pajisjet janë kyçur në sistemin ekzistues të furnizimit. Në ndërkohë pas montimit të pajisjeve telekomunikuese në NS Gjilani 5 është bërë komisionimi i linjave optike, respektivisht kontinuiteti i fijeve optike.		
6	Ndërrimi i Pajisjeve të Tensionit të Lartë në NS Prizreni 2 dhe Instalimi i ATR3, 150 MVA (LOT1)	10,000,000.00	ECL0	6,308,920.00 €	10.01.2011	09.07.2012	KONCAR (H)	0.00 €	(i.) Projekti është në fazën e implementimit. Gjatë kësaj periudhe kontraktuesi KONCAR ka pasë aktivitetet të ngjeshura në teren: është energjizuar Transformatori ATR3. Kontraktuesi ka punuar intensivisht në punët ndërtimore në dy fushat transformatorike tjera dhe dy fushat e linjave 110 kV dhe ka bërë përmirësimin e fushës lidhëse 110 kV. Pajisjet e mbrojtjes tele, ormanat e matjeve me bay control unit-a, të cilat janë testuar në fabrikë, kanë arritur në NS Prizreni 2, janë vendosur ormanat e kabllove. Gjatë kësaj periudhe kontraktuesi ka vazhduar me punët, kryesisht është punuar në fushat E02; E05; E07; E06; si dhe D07. Është më se e rëndësishme të ceket		



**Raport për tremujorin e tretë
2012**

DT-FI-008

ver. 1.1

faqe 20 nga 44

Departamenti Financiar

Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:

7	<p>TI për Operatorin e Tregut (LOT2)</p>			2,389,000.00 €	KOSTT	1,959,800.80€	01.06.2011	20.12.2011	09.01.2012	Siemens (At)	0.00 €	<p>se janë kryer SAT-at për pajisjet e tensionit të lartë si dhe është kryer edhe nga ana e ALSTOM-it komisionimi i fushave E02; E05; dhe E07 dhe këto fusha kanë qenë të gatshme për me u lëshu në punë. Gjatë muajit shtator kontraktuesi ka bërë energjizimin e fushës lidhëse 110 kV si dhe dy fushat e linjave që shkojnë për NS Gjakoven 2 dhe NS Prizreni 3. Kontraktuesi ka vazhduar intensivisht me punët ndërtimore në lysterjen e ndërtësës komanduese, janë kryer të gjithë SAT-at për fushat 220 kV të Transformatorëve dhe ato në fushat 100 kV.</p> <p>(ii) Projekti ka vonesa në kompletim, dhe sipas planit të ri dinamik, të freskuar dhe të pranuar nga Autoriteti Kontraktues EUOK dhe KOSTT, projekti parashiet të kompletohet më 26.11.2012.</p> <p>(i) Gjatë këtyre muajve nuk ka pasë ndonjë aktivitet sa i përket LOT2 - Është përgatitur specifikimi për Fire Walls dhe është dërguar në prokurim për procesim të mëtejshëm. Njëherit gjatë këtij muaji nuk ka pasë ndonjë vërejtje për mosfunksionim të projektit nga OT. Kemi marr informata nga Prokurmenti i KOSTT se Fire Walls janë blerë dhe se së shpejti ECLO (EUOK) do të nënshkruan kontratën për implementimin e tyre nga Siemens, kështu që ky projekt do të jetë për procesim të mëtejshëm.</p>
8	<p>Ndërrimi i përçuesit, izolatorëve dhe pajisjeve lidhëse në LP 125/2 dhe 125/3</p>			2,389,000.00 €	KOSTT	1,959,800.80€	01.06.2011	20.12.2011	09.01.2012	Siemens (At)	0.00 €	<p>(i) Projekti është në fazën e implementimit. Gjatë kësaj periudhe stafi i KOSTT-it së bashku me kontraktuesin dhe komisionin e formuar nga Komuna e Vushtrrisë ka zgjedhur problemet pronësore juridike sa i përket komunës së Vushtrrisë dhe pastaj ka qenë detyrë e kontraktuesit të fillojë me implementimin e projektit. Sa i përket komunës së Mitrovicës, ka pasur probleme me pronarët e tokave se ku do të vendosen shpyllat e reja. Përveç shpyllave me numer 3,5,9(linja e njëfishitë) dhe shpyllat 6,9,11,13 (linja e dyfishitë) tek të cilat nuk është filluar me punë, ndërsa te shpyllat tjera është bërë vendosja e bazamenteve, mirëpo nuk janë ngritur shpyllat komplet pasi që ka munguar struktura metalike për ngritjen e tyre. Në fshatin Frasher janë papaparatë të ndërtohen shpyllat me numër 16,17,18,19,20,21,22 (linja e njëfishitë) dhe 1,2,3,4 (linja e dyfishitë) por fshatarët e kanë penguar ndërtimin e tyre dhe për këtë problem të</p> <p>Kontraktuesi të zhvillojë implementimin e projektit konform kushteve të kontratës.</p>



Raport për tremujorin e tretë 2012		DT-FI-008
<i>ver. 1.1</i>		<i>Jaqe 21 nga 44</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		
<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>		

9	Kycja e NS Lipjanit në linjën LP 212 (Kosova A - Ferizaj 2)	1,050,000.00 €	KOSTT	1,397,094.32 €	27.06.2011	27.07.2012	UMEL (B&H)	0.00 €	<p>ngritur është angazhuar edhe kryetari i komunës së Mitrovicës dhe menaxhmenti i KOSTT-it. Mirëpo edhe përkundër kësaj pronarët e tokave nuk kanë pranuar dhe ka mbetur që me datë 04.10.2012 të fillohet me punët në shtyllat numër 15, 16 dhe 17 në prezencë të policisë.</p> <p>(ii) Pengesat kanë qenë nga ana e fshatarëve në fshatin Frashër pasi që kanë penguar ngritjen e shtyllave, por ka mbetur që punët të fillojnë në prezencën e policisë.</p> <p>(i.) Sa i përket pajisjeve, kontraktuesi ka mundur të fillojë me implementimin e projektit, por pasi që çështjet pronësore nuk janë zgjidhur me pronarët e tokës ku do të vendosen shtyllat e tensionit të lartë, nuk ka qenë e mundur të fillohet. Me datë 15.06.2012 është marrë leja urbanistike për ndërtimin e linjës 110 kV nëpër komunën e Lipjanit dhe Graçanicës. Pasi të kryhet shpronësimi do të aplikojmë për marrjen e lejes ndërtimore, gjithashtu është ra në dakord që afati për kryerjen e këtij projekti të jetë deri në fund të vitit 2012. Nga agjencioni për menaxhimin e emergjencave është kërkuar të marrim pëlqim për mbrojtje nga zjarri.</p> <p>Në proces është marrja e lejes nga MMPH, e cila ka kërkuar edhe disa dokumente si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Leja ndërtimore ekzistuese e nënstationit - Projekti i gjendjes ekzistuese - Situacioni - Projekti kryesor për pjesën e zgjerimit të nënstationit, etj. <p>Të gjitha këto dokumente u janë kërkuar kontraktuesit i cili duhet ti përgatis sa më shpejt.</p>	Që dokumentacioni i kërkuar të jetë plotësisht sipas kërkesave të KOSTT-it.
10	Ndërrimi i Mbrojtjeve Rele në NS 110/35kV Prishtina 2 dhe Prishtina 3	250,000.00 €	KOSTT	168,880.32 €	11.07.2011	02.01.2012	KONCAR-KET (HP)	0.00 €	<p>(i.) Projekti është në afatin garantues</p>	<p>Të eliminohen vërejtjet e dhëna nga Komisioni për Pranim Teknik Intern, nga ana e kontraktuesit.</p>



	Raport për tremujorin e tretë 2012		DT-FI-008	
	<i>ver. 1.1</i>		<i>faqe 22 nga 44</i>	
Departamenti Financiar				
Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:				

11	Rehabilitimi në linjat 110kV, 126/4 (pjesa e vjetër), 179/1, 1801 (ndërrimi i izolatorëve dhe urave përçuese)	150,000.00 €	KOST	51,976.60 €	25.09.2011	17.12.2011	ELEGANCA (RKS)	10,000.00 €	<p>(i.) Kanë përfunduar punët në LP.110 kV nr.1801. Kan përfunduar punët në LP.179/1 dhe LP.126/4. Është bërë pranimi intern teknik i punëve dhe është lëshuar Certifikata e pranimit të përkohshëm të punëve. Projekti është në fazë garantuese njëvjeçare.</p>	
12	Ndarja e zbarrave në dy seksione në NS Gjilani 1 dhe NS Therande	150,000.00 €	KOST	36,951.57 €	09.08.2011	27.01.2012	Ukab (RKS)	0.00 €	<p>(ii.) Kontraktuesi "Ukab" ka montuar ndarësin në NS Theranda dhe njëkohësisht ka bërë ndërrimin e kahjes së hapjes së ndarësit të fushës transformatorike në mënyrë që të mos ekzistojë mundësia e shkakimit të ndonjë avarie gjatë manipulimit me ndarës. Për NS Gjilani është vendosur ndarësi mirëpo nuk kemi mundur me e kyçë sepse ende nuk e kemi marrë pëlqimin për shkyçe totale për NS Gjilani 1. Kontraktuesi ka bërë kërkesë që më datën 15.09.2012 ti mundësohet çkyçja dhe të përfundojë pjesën e projektit për nënstationin e lartpërmendur, prandaj vetëm kur marrim pëlqimin nga Qendra Nacionale Dispečerike për çkyçje të NS Gjilani 1, do të kyçim ndarësin për ndarjen e zbarrave në dy seksione. Kontraktuesi "Ukab" ka montuar ndarësin në NS Gjilani 1 dhe më datën 01.10.2012 ka dalë komisioni për pranim intern teknik, i cili komision ka dhënë disa vërejtje që duhet përmirësuar deri më datën 19.10.2012.</p>	<p>Të eliminohen vërejtjet, e dhëna nga Komisioni për Pranim Teknik Intern, nga ana e kontraktuesit.</p>
13	Paket Projekti NS 110/10(20) kV – Gjilani 5	10.18 milionë CHF	Donacion nga Qeveria Zvictrane	6.200 CHF	03.12.2010	21.06.2012	Areva/Energoinvest	0.00 €	<p>(i) Ky projekt është në menaxhim të KEK -ut por gjatë këtyre muajve është mbajtur korespondenca për disa çështje në lidhje me SCADA-n që KEK nuk i ka marrë parasysh vërejtjet e KOSTT-it për të cilën gjë është dakordur edhe KEK-u, gjithashtu janë mbajtur të gjitha SAT si për qarqe primare ashtu edhe për qarqe sekundare dhe projekti është në fazën përfundimtare.</p>	



Raport për tremujorin e tretë 2012

DT-FI-008

ver. 1.1

fajqe 23 nga 44

Departamenti Financiar

Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:

<p>14</p> <p>Rialokimi i linjës 110kV, nr.1806 NS Gjakova 1- Gjakova 2 dhe Rehabilitimi i pajisjeve të TL në NS Gjakova 1</p>	<p>1,500,000.00 €</p>	<p>KOSTT</p>	<p>3,267,253.00 €</p>	<p>02.12.2011</p>	<p>29.06.2012 (120 ditë punë)</p>	<p>UKab (RKS)/ELSA (S)</p>	<p>0.00 €</p>	<p>(i.) Gjatë kësaj periudhe është dorëzuar dizajni bazë të cilin e kemi dorëzuar në Zyren për Çështje Ligjore, mirëpo nuk ka pasë ndonjë aktivitet në teren sepse nuk e kanë marrë lejen për ndërtim. Është mbajtur mbledhja mujore me datën 27.07.2012 ku u është bërë me dije procesi dhe procedurat e Kostt-it që Konzorcioumi duhet ti marrë parasysh. UKAB ka kërkuar që ti lejohet puna në ndërtimin e murit dhe KOSTT-i ia ka lejuar përmes certifikatës për leje për punë (Site Hand Over Certificate) vetëm në murin rreth lumit për konzorcioumin UKAB - ELSA - Bohemia Muller, me arsyetim se gjatë sezonës së vjeshtës dhe dimrit kushtet klimatike nuk lejojnë punët në ndërtimin e murit mbrojtës skaj lumit. Janë mbajtur FAT-at për Ndërprerësa, Ndarësa, TMRR dhe TMT. Ka ngelur pa u kry FAT-i për Mbrojtje dhe OPGW.</p> <p>(ii.) Projekti ka vonesa të konsiderueshme, të shkaktuara nga ana e kontraktuesit, si pasojë e mosperformancës sipas kushteve të kontratës dhe procedurave në sigurimin e lejeve urbanistike dhe ndërtimore.</p>	<p>Është kërkuar nga kontraktuesi që dokumentacioni i kërkuar/dizajni të jetë plotësisht sipas kërkesave të KOSTT-it, konform Ligjit për Ndërtim dhe Ligjit mbi Shpronësimet.</p>
<p>15</p> <p>Rehabilitimi i pajisjeve për shpenzime vetjake në NS 400/220kV - Kosova B</p>	<p>250,000.00 €</p>	<p>KOSTT</p>	<p>272,409.00 €</p>	<p>12.12.2011</p>	<p>20.07.2012 (150 ditë punë)</p>	<p>Monting (RKS)</p>	<p>53,877.35 €</p>	<p>(i.) Projekti është në fazën e implementimit. Kontraktori gjatë këtyre muajve ka bërë këto punë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - testimi i lidhjeve, komandimit dhe sinjalizimit të ormanit NE04 - ardhja nga Transformatori -T6 si dhe energjizimi i zbarrave te ormanat e shpërndarjes =NE02 3 4 5 6 dhe 7 - bartja e shpenzuesve një nga një nga ormanat ekzistues HV2,HV5,HV6,HV7 dhe HV5 në ormanat e ri NE02,5,6,7 - montimi i pajisjeve të reja të shpërndarjes me AC NE01,2,3,4,5,6,7 në lokacionin e ri te dhoma e kthunave 6kV, - testimi i lidhjeve, funksionimit, sinjalizimeve - bartja e shpenzuesve një nga një në ormanat e ri si dhe lëshimi në punë - bartja një nga një e shpenzuesve në ormanat e ri NK03 dhe NK04 - bartja një nga një e shpenzuesve në ormanat e ri NK07 dhe NK08 - lidhja provizore nga qarku A i sinjalizimeve në ormanin e mbrojtjeve për të - lidhjet e kabllove, testimet si dhe lëshimi në punë përmes lidhjeve të reja. 	<p>Arsye e vonesës është mospunimi i kushteve për punë për kontraktuesin – shkyqjet e nevojshme të fushave 400 dhe 220 kV, me theks të posaçëm të fushave të linjave interkonektive dhe ato transformatorike.</p>



Raport për tremujorin e tretë 2012

DT-FI-008

ver. 1.1

faqe 24 nga 44

Departamenti Financiar

Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:

16	Rehabilitimi i pajisjeve të tenisorit të lartë (TL) 110kV në NS Gjilani 1 dhe NS Ferizaj 1	1,150,000.00 €	KOSTT	960,031.00 €	18.02.2012	17.12.2012	Enbi-Power (AD)	271,219.11 €	<p>(ii.) Projekti pritet të kompletohet në fund të muajit tetor 2012.</p> <p>(i.) Gjatë këtyre muajve kontraktuesi ka përgaditur projektin dhe për të njetin projekt kemi kërkuar që të bëhet revidimi i tij nga një kompani e tretë. Pasi kemi pranuar projektin e reviduar kemi aplikuar në Ministrinë e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor për marrjen e lejes ndërtimore. Sipas zyrtarëve të kësaj Ministrie, Ligji i ri për Ndërtim nuk e parasheh marrjen e lejes ndërtimore për këtë projekt, mirëpo ata janë konsultuar edhe me USAID-in se si të veprohet në këtë rast. Gjatë këtyre muajve është mbajtur edhe FAT për ndarësa në Itali pasi është aprovuar DTS-i. Kontraktuesi po ashtu ka sjellë ndërprerësat, ndarësat për projektin në fjalë. Nga kontraktuesi është kërkuar dërgimi i planit dinamik dhe metodologjisë së punëve ku pas dërgimit të tyre ne kemi paraqitur disa vërejtje sa i përketë shkyçjeve të linjave. Ka mbetur që pas aprovimit të planit dinamik dhe metodologjisë së punëve të korigjuar për vërejtjet e dhëna nga ana jonë, të fillohet me implemmentimin e punëve në teren.</p>	<p>Që dokumentacioni i kërkuar të jetë plotësisht sipas kërkesave të KOSTT-it dhe projekti të zbatohet konform kushteve të kontratës dhe Procedurave për Menaxhimin e Projekteve, dokument i KOSTT-it.</p>
17	Instalimi i dy fushave të reja të linjave 110kV në NS Prizreni 2	600,000.00 €	KOSTT	551,998.00 €	17.02.2012	03.08.2012	UKab (RKS)	196,160.00 €	<p>(i.) Projekti është në fazën e implemmentimit. Gjatë këtyre muajve janë bërë këto punë: kontraktuesit i është lëshuar certifikata për fillimin e punëve dhe është mbajtur FAT për mbrojtje rele dhe kontroll pjesërisht, pasi që ormanat e mbrojtjes nuk kanë qenë në Schneider në Rumani. Kontraktuesi e ka sjellë dizajnin bazë dhe iu është aprovuar. Poashtu iu është aprovuar edhe Time schedule (plani dinamik). Kontraktuesi gjatë muajit të fundit ka punuar kryesisht në punët ndërtimore, janë përfunduar të gjitha bazamentet e pajisjeve të tensionit të lartë si dhe kanali i kabllove, është vazhduar me montimin e konstruksioneve metalike. Projekti ka pasur vonesa dhe nuk është zhvilluar sipas planit dinamik të kryerjes së punëve apo Time Schedule, mirëpo projekti është zhvilluar konform kontratës. Është bërë një kërkesë nga ana e kontraktuesit për punët shtesë në lidhje me portalin e zbarrës të cilën e kemi dërguar në Departamentin e Prokurimit për procedim të metufjeshëm. Në proces është aprovimi i diagramit të lidhjeve dhe dakordimi i FAT-it për mbrojtje dhe kontroll - pjesa e dytë.</p>	<p>Që dokumentacioni i kërkuar të jetë plotësisht sipas kërkesave të KOSTT-it dhe projekti të zbatohet konform kushteve të kontratës dhe Procedurave për Menaxhimin e Projekteve, dokument i KOSTT-it.</p>



Raport për tremujorin e tretë 2012

DT-FI-008

ver. 1.1

faqe 25 nga 44

Departamenti Financiar

Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:

18	LOT1: Rehabilitimi i stabilimenteve te TL ne NS Gjakova 2	2,100,000.00 €	KOSTI	13.06.2012	15.09.2012 (58 ditë pune)	Lika Trade (RKS)	167,924.40 €	0.00 €	0.00 €	(i.) Bordi i Drejtorëve ka aprovuar kërkesën e KOSTIT për buxhet shtesë për këtë projekt. ToR dhe Specifikimi Teknik për projekt kanë përfunduar dhe është dorëzuar në Departamentin e Prokurimit për procesin e tenderimit.	
19	LOT2: Rehabilitimi i stabilimenteve të TL në NS Prizreni 3	2,100,000.00 €	KOSTI					0.00 €	0.00 €	(i.) Bordi i Drejtorëve ka aprovuar kërkesën e KOSTIT për buxhet shtesë për projekt. ToR dhe Specifikimi Teknik për projekt kanë përfunduar dhe është dorëzuar në Departamentin e Prokurimit për procesin e tenderimit.	
20	Furnizimi me softuerin E-Plan	50,000.00 €	KOSTI					0.00 €	0.00 €	(i.) Termat e Referencës dhe Specifikimet Teknikë janë përgatitur me kohë dhe janë dorëzuar në Departamentin e Prokurimit me 23.01.2012, për procesin e tenderimit.	
21	Asfaltimi i rrugës së çasjes për në NS 400/110 kV - Peja 3	150,000.00 €	KOSTI	13.06.2012	15.09.2012 (58 ditë pune)	Lika Trade (RKS)	167,924.40 €	0.00 €	0.00 €	(i.) Është zgjedhur kontraktuesi i punëve. Është mbajtur takimi i parë. Është dorëzuar projekti dhe është aplikuar për leje ndërtimore në komunën e Istogut. Pas marrjes së lejes ndërtimore kontraktuesi ka filluar me punë me datën 14.08.2012. Kontraktuesi ka punuar kryesisht në zgjerimin e rrugës (hekja e dheut dhe shtrimi zhavorrit.) (ii.) Për arsye të punëve shtesë, janë ndërprerë punët. Është dhënë arsyeshmëria teknike për punët shtesë dhe Departamenti i Prokurimit ka proceduar lëndën më tutje.	
22	Ndërtimi i rrethojës së në NS 400/220 kV - Kosova B dhe Instalimi i ndriçimit përgjatë saj	450,000.00 €	KOSTI					0.00 €	0.00 €	(i.) Pas aprovimit të buxhetit shtesë nga ana e Bordit të Drejtorëve, dokumenti është ridërguar në prokurim për procedura të mëtejme.	Projekti është në fazën e prokurimit



Departamenti Financiar

Raport për tremujorin e tretë
2012

ver. 1.1

Sektori i Buxhejt dhe Planifikimi Strategjik:

DT-FI-008

faqe 26 nga 44

23	<i>Instalimi i kamerave vëzhguese (CCTV) në NS Kosova B dhe Depo</i>	100,000.00 €	KOSTT				0.00 €	(i.) Dokumenti është në prokurim për procedura të mëtejme - nuk ka pasë kërkesa për ndonjë aktivitet shtesë	Projekti është në fazën e prokurimit
24	<i>Instalimi i grupeve matëse sipas kufirit të rinj KOSTT/KEK (OSSH)</i>		KOSTT				0.00 €	(i.) Pas dorëzimit të raportit nga komisioni punues si dhe raportit nga sektori për Planifikim dhe analizë, në bashkëpunim me specialistët e lëmvje përkatëse është punuar në përgatitjen e specifikimit teknik për projekt. Është mbajtur prezantimi për grupet matëse, me datë 24.09.2012 është mbajtur takimi i përbashkët me SO (për definimin e kërkesave). Gjatë muajit shtator është punuar në kompletimin e specifikimit teknik. TeR dhe Specifikimi Teknik janë dorëzuar në Departamentin e Prokurimit për procesin e tenderimit.	
25	<i>Linja 400 kV Kosovë – Shqipëri</i>		KFW dhe KOSTT				0.00 €	(ii.) Ende nuk është nënshkruar kontrata me asnjë kontraktor.	
26	<i>Ndërtimi i rrethojës së re në NS Kosova B dhe Instalimi i ndriçimit përreth saj</i>		KOSTT				0.00 €	(i.) TeR dhe Specifikimi Teknik janë dorëzuar në Departamentin e Prokurimit për procesin e tenderimit.	

2.4. Çështjet rregullative

Shqyrtimi i Gjashtë i Tarifave të Energjisë Elektrike (SHTE6)

Më 6 korrik është dërguar Aplikacionin për Tarifa dhe Ngarkesa të OST/OT në ZRrE.

Më 20 Korrik 2012 është pranuar nga ZRrE vendimi V_418_2012 për tarifat dhe ngarkesat e transmisionit, që do të zbatohen nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut të Kosovës (KOSTT) SH. A. nga data 1 qershor 2012.

I njëjti dokument është publikuar në ueb-faqen e ZRRE-së dhe ka përfunduar si proces Shqyrtimi i Gjashtë i Tarifave të Energjisë Elektrike (SHTE6).

Shqyrtimi i shtatë i tarifave (shumë-vjeçare) të energjisë elektrike (SHTE7)

Më 9 korrik KOSTT ka pranuar nga ZRrE **Formularët Raportues** në kuadër të Shqyrtimit të Shtatë (shumë-vjeçar) të Tarifave të Energjisë Elektrike (SHTE7).

Sipas kërkesave dhe planit kohor të përcaktuar nga ZRrE, më 31 gusht është dërguar Aplikacioni për Tarifa në kuadër të Shqyrtimit të Shtatë të Tarifës (shumë vjeçare) së Energjisë Elektrike (SHTE7).

ZRrE ftoi seancën publike në kuadër të Shqyrtimit të Shtatë të Tarifave të energjisë elektrike (SHTE 7). Seanca u mbajt më 3 shtator, në ora 10:00. Qëllimi i seancës ishte që në kuadër të SHTE 7 t'ju ofrojë mundësi palëve të interesit që të dëgjojnë argumentet e të licencuarve (KEK-ut dhe KOSTT-it) lidhur me aplikacionet për të hyrat e lejuara maksimale për pesë vitet e ardhme dhe tarifat e reja që pritet të jenë efektive prej datës 1 prill 2013.

Me 5 shtator dhe me 12 shtator me kërkesë të ZRrE-së janë mbajtur takime në selinë e KOSTT në lidhje me Formularët Raportues, sqarimit të shumave të caktuara të vendosura në to dhe referencat e bazuara në ato shuma.

Më 24 Shtator, KOSTT ka dërguar në ZRrE Aplikacionin për tarifa-Sqarime Shtesë, bazuar në kërkesat e ZRrE-së lidhur me çështjet e ngritura në takimin për SHTE 7 të datës 05 dhe 12 shtator 2012.

Më 27 Shtator ZRrE-ja ka kërkuar përmes postës elektronike sqarime shtesë në lidhje me Formularët Raportues, kurse me 5 tetor janë dërguar në ZRrE sqarime shtesë së bashku me Formularët e përmirësuar dhe shtojcat mbi arsyeshmërinë e investimeve kapitale.

Modeli për Planifikim Afatgjatë Financiar

*Me 14 Maj 2012, është nënshkruar Kontrata për projektin: **Modeli për Planifikim Afatgjatë Financiar** dhe protokolluar me numër identifikues KOSTT 5519/1-12-79/11-221 Ofruesi i Shërbimeve është KPMG Bullgaria OOD dhe KPMG Albania Sh.p.k.- Dega në Kosovë.*

Me 31 Maj 2012, në KOSTT është mbajtur takimi i parë me KPMG. U diskutua për orarin e punëve dhe caktimi i detyrave për secilin. Gjatë muajit qershor janë zhvilluar aktivitete sipas planit dinamik të projektit.

	Raport për tremujorin e tretë 2012	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 28 nga 44</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>

Me 13 korrik është pranuar Draft i parë i Modelit Financiar. Gjatë periudhës 31 maj deri në mesin e shtatorit janë zhvilluar më shumë se 30 takime, çka ka rezultuar edhe me kompletimin e Modelit Financiar me të dhënat bazë.

Vendimi i ZRrE-së lidhur me kontestin e ngritur nga KOSTT sh.a. ndaj KEK sh.a.


Me 26 Qershor 2012, KOSTT ka pranuar nga ZRrE Njoftimin lidhur me shtyrjen e afatit për 30 ditë për shqyrtimin e kontestit të inicuar nga KOSTT lidhur me refuzimin e pagesës së faturave nga KEK për Nëntor dhe Dhjetor 2011.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 18 korrik 2012 ka marrë vendim nr. V_428_2012 për kontestin e ngritur nga KOSTT-i kundër KEK-ut lidhur me “Refuzimin e pagesës për shërbimet e transmisionit dhe kthimin e faturave për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor të vitit 2011”. Në këtë vendim është theksuar se **APROVOHET** kërkesa e KOSTT-it dhe obligohet KEK-u t'i paguaj KOSTT-it faturat për periudhën tetor, nëntor dhe dhjetor të vitit 2011 në vlerë prej **3,802,949 €**.

Me datë 24 gusht KOSTT e ka dërguar një shkresë në KEK përmes të së cilës kërkohet nga KEK që të zbatojë vendimin e ZRrE-së.

Lidhur me këtë shkresë, me datë 27 gusht, KEK ka dërguar përgjigje ndaj shkresës së KOSTT, në të cilën është bashkangjitur ankesa e KEK në Gjykatën Supreme të Kosovës lidhur me vendimin e ZRrE-së dhe me të cilën KEK thekson se ka dorëzuar ankesë ndaj vendimit në fjalë dhe nuk do të paguaj faturat sipas Vendimit.

Me 05 shtator, ZRrE kërkon informacion nga KOSTT nëse është bërë ekzekutimi i Vendimit të Bordit të ZRrE-së nr. V_428_2012 nga KEK-u, për kontestin mes KOSTT dhe KEK.. KOSTT e ka informuar ZRrE-në se nuk është duke u zbatuar vendimi nga ana e KEK.

	Raport për tremujorin e tretë 2012	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 29 nga 44</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>

2.5. Shqyrtimi i përfomancës financiare

2.5.1. Draft Pasqyrat Financiare: BILANCI I GJENDJES

	Nota	Janar- Shtator/2011	Janar- Shtator/2012	%
ASETET JO QARKULLUESE		94,774,806	109,110,160	115.13%
Prona, Fabrika dhe Paisjet	4	72,348,069	104,553,806	144.51%
Investimet në vijim	5	22,426,737	4,556,354	20.32%
ASETET QARKULLUESE		34,908,942	31,315,014	89.70%
Stoqet,pjesët rezervë dhe veglat	6	1,191,980	1,641,637	137.72%
Kërkesat	7	6,752,349	9,627,468	142.58%
Kredi,avanse dhe depozita	8	6,092,114	847,134	13.91%
Tatimi i parapaguar		171,867	266,195	154.88%
Paraja dhe Bilanci Bankar	9	20,700,631	18,932,579	91.46%
TOTALI I MJETEVE		129,683,748	140,425,174	108.28%
KAPITALI I AKSIONARËVE DHE REZERVAT		46,333,073	55,854,628	120.55%
Kapitali Aksionar	10	25,000	25,000	100.00%
Kapitali i trashëguar	11	28,346,963	38,176,268	134.67%
Fitimi i mbajtur		14,084,667	15,367,648	109.11%
				0.00%
Fitimi aktual		3,876,443	2,285,712	58.96%
OBLIGIMET JO QARKULLUESE		75,707,750	75,085,440	99.18%
Të hyrat e shtyera	12	75,707,750	75,085,440	99.18%
OBLIGIMET QARKULLUESE		7,642,925	9,485,106	124.10%
Obl.nga tregtia dhe obl.tjera	13	7,642,925	9,485,106	124.10%
TOTAL BURIMET E MJETEVE		129,683,748	140,425,174	108.28%



Raport për tremujorin e tretë 2012

DT-FI-008

ver. 1.1


faqe 30 nga 44

Departamenti Financiar

Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:

DRAFT PASQYRA E FITIMIT DHE HUMBJES

	Nota	Plani Janar- Shtator 2011	Realiz. Janar- Shtator 2011	% real/ plani 2011	Plani Janar- Shtator 2012	Realiz. Janar- Shtator 2012	% real/ plani 2012	% realiz 2012/2011
Të hyrat nga tarifa	15	11,064,169	11,420,255	103.2%	11,610,386	11,036,513	95.1%	96.6%
Të hyrat tjera	16	2,865,030	2,891,679	100.9%	2,550,000	4,177,418	163.8%	144.5%
Të hyrat totale		13,929,199	14,311,934	102.7%	14,160,386	15,213,931	107.4%	106.3%
Shpenzimet e personelit	17	2,003,011	1,959,786	97.8%	3,094,985	2,608,256	84.3%	133.1%
Shpenzimet e materialit		39,000	28,794	73.8%	54,000	30,124	55.8%	104.6%
Kompenzimet Bordinë Drejtorve		47,250	54,566	115.5%	47,250	31,938	67.6%	58.5%
Amortizimi	4	4,012,500	4,170,058	103.9%	4,875,000	6,456,785	132.4%	154.8%
Energjia, telefoni, uji	18	171,585	164,386	95.8%	270,585	246,694	91.2%	150.1%
Riparime dhe mirëmbajtje		834,975	567,914	68.0%	1,229,805	445,409	36.2%	78.4%
Derivate dhe lubrifikante		69,901	65,566	93.8%	76,500	76,142	99.5%	116.1%
Mediona, siguria dhe transporti	20	234,000	156,278	66.8%	152,250	94,046	61.8%	60.2%
Shpenzimet tjera operative	19	900,179	508,681	56.5%	641,415	520,400	81.1%	102.3%
Kompenzimet tjera.		27,750	32,073	115.6%	27,750	20,671	74.5%	64.5%
Humbjet në bartje	21	3,008,537	2,727,390	90.7%	3,131,208	2,397,752	76.6%	87.9%
Rregullimi sekondar		0						
Shpenzimet totale		11,348,688	10,435,491	92.0%	13,600,748	12,928,218	95.1%	123.9%
Fitimi para Tatimit		2,580,511	3,876,443		559,638	2,285,712		
Tatimi në fitim	22							
Fitimi për periudhë		2,580,511	3,876,443		559,638	2,285,712		

	Raport për tremujorin e tretë 2012		DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 31 nga 44</i>	
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>	

2.5.2. Analiza e IKP-ve financiare

IKP-të financiare të zgjedhura për të paraqitur performancën financiare të KOSTT-it, janë të matshëm në baza vjetore dhe në baza kuartale. Indikatorët e paraqitur në këtë tabelë janë të matshëm në baza kuartale.

Treguesi	VII-IX 2011	VII-IX 2012	Spjegimet
T1. Fitimi operativ margjinal = Fitimi nëto / gjithësejt të hyrat	0.3	0.2	<p>Qëllimi është që të jetë mbi zero. Është treguesi i cili më së miri paraqet nivelin e të hyrave nga operacionët vijuese.</p> <p>Ky tregues matë se çfarë përqindje e të hyrave të kompanisë, mbetet pasi që ajo t'i paguaj të gjitha shpenzimet variabile si: pagat, materialet, shërbimet, etj. Sa më i lartë është ky tregues, kompania është në gjendje më të mirë.</p>
T2. Treguesi i qarkullimit = asetet qarkulluese/detyrimet qarkulluese	4.6	3.3	<p>Tregon aftësinë e kompanisë për t'i përmbushur obligimet e saj afatshkurtera, me mjetet (asetet) e saj afatshkurtera. Optimalja e këtij treguesi është 1.5.</p>
T4. Mbulimi i shp-operative = gjith. të hyrat/ shpenzimet operative	1.2	1.2	<p>Tregon raportin e të hyrave dhe shpenzimeve operative të realizuara. Treguesi duhet të jetë më i madh ose =1</p>
T5. Mbulimi i të hyrave = gjith. të hyrat/ shpenzimet e lejuara	1.1	1.1	<p>Treguesi duhet të jetë më i madh ose =1</p>
T6. Mbulimi i shp. të lejuara = shpenzimet e lejuara/ gjithësejt të hyrat	0.8	0.9	<p>Treguesi duhet të jetë më i vogël se 1 ose =1</p>
T7. Gjith. të hyrat ndaj të hyr. të lej = gjith. të hyrat e rregulluara/ të hyrat e lejuara	1.1	1.1	<p>Këtu vihen në raport vetëm të hyrat e rregulluara të realizuara dhe të hyrat e lejuara. Treguesi duhet të jetë =1.</p>



Departamenti Financiar

Raport për tremujorin e tretë
2012

par. 1.1

Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:

DT-FI-008

faqe 32 nga 44

T12. Shpenzimet e lejuara për GWh e transmetuara	3.4	3.4	Ky indikator ndërlidhet me metodologjinë e tarifave të ZRrE-së, e cila për periudhën raportuese ka lejuar shpenzimet totale për njësi 3.3m €/GWh. Ky indikator tuije analizohet duke iu referuar treguesit T14 , që paraqet shpenzimet totale (të realizuara) për njësi, ku shihet se KOSTT ka transmetuar energji me shpenzimet reale 3.3 m €/GWh.
T13. Të hyrat e lejuara për GWh e transmetuara	3.5	3.6	Paraqet të hyrat për njësi. Objekti: Efikasiteti në terma relative të shpenzimeve që i referohen humbjeve teknike
T14. Shpenzimet totale për njësi=shp.totale/GWh e transmetuara	2.6	3.3	Objekti: Efikasiteti në terma relative të shpenzimeve që i referohen humbjeve teknike

